

**RAPORTI PER FUNDIMTAR I GRUPIT TË
VLERËSIMIT TË JASHTËM
PËR PROGRAMIN E STUDIMIT:**

**MASTER PROFESIONAL
në
“MENAXHIM BIZNESI, PROFILI: MENAXHIM ARTI”**

SHKOLLA E LARTË PRIVATE
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË

Eksperti: Dr. Gëzim Qëndro

Tiranë, maj 2012

Hyrje

Përbërja e GVJ

Parimet e Punës së GVJ

- Besimi
- Vlerësimi i mbështetur në dokumenta të paraqitura nga GVB, Institucioni etj.
-

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi, profile: Menaxhim Arti

- Të dhëna për hapjen e programit të studimit

Tabela format për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi, profili: Menaxhim Arti mbështetur në Standardet shtetërorë për programet e studimit të Ciklit të Dytë	
Standardet/kriteret	Mendimi i GVJ për përmbushjen e standardit/kriterit¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Programi i studimit MP Menaxhim Biznesi, profili: Menaxhim Arti është i organizuar në module me vlerësim në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kreditet që duhet të plotësohen për të përfunduar me sukses programin Master Profesional janë 60 ECTS . Programet e studimeve respektojnë sistemin Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Programi i studimeve me 60 kredite është (sasia mesatare) modeli i njohur në shumë universitete brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ky program studimi realizohet në një vit akademik.
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Qëllimi dhe misioni i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është përgatitja e specialistëve të aftë në fushat e artit në mënyrë që ato, me njohuritë e fituara të jenë në gjendje të orientohen në tregun e punës dhe ta shfrytëzojnë atë duke iu përgjigjur kërkesave për vende pune jo vetëm në stadiet e zhvillimeve aktuale por edhe atyre perspektive, jo vetëm në nivel kombëtar por edhe rajonal e më gjërë. Programi i studimit MP Menaxhim Biznesi, profili: Menaxhim Arti është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

	Mendoj se programet u përgjigjen qëllimeve dhe misionit të UMSH-së që është përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik dhe privat si dhe gjenenimin e ideve dhe zgjidhjeve për sfidat që qëndrojnë përpara vendit dhe rajonit.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Në mungesë të një tregu pune (privat) për menaxherë arti mendoj se është vështirë të përcaktosh nevojat e këtij tregu. Vetëm sektori publik nuk mjafton. Aq më tepër kur mëtohet t'u paraprihet këtyre nevojave. Mendoj se duhet bërë një studim ku të përcaktohen qartë nevojat e tregut të artit, sidomos atij privat për menaxherë dhe ekspertë.
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Në strategjinë e zhvillimit të vendit një rol të veçantë luan një rol të vecantë për të ofruar mundësi si artistëve të afirmuar në fushën e artit dhe me një përvojë të gjatë ashtu dhe studentëve të cilët diplomohen në fusha të ndryshme të artit. Ky zhvillim merret në konsideratë në programin e studimit. I shqyrtuar si një proces kompleks ku bashkëveprojnë faktorë politikë, ekonomikë e shoqërorë ai konsiderohet prej programit të studimit si në pasqyrimin aktual ashtu edhe në organizimin fleksibël për tu përshtatur me perspektiven.
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Mendoj se programet e studimit të UMSH-së përputhen me nevojat imediate, por sidomos duhet theksuar rëndësia që i vihet në këto programe jo vetëm zhvillimit kulturor të Shqipërisë por edhe përfshirjes së këtij zhvillimi në një kontekst mesdhetar çka edhe e dallon këtë universitet nga të tjerët. Kjo ndër të tjera zgjeron mjaft gamën e shkëmbimeve kulturore me institucione dhe organizma të tjerë kulturore dhe arsimorë në këtë rajon kaq të gjerë me një larmi të spikatur kulturore dhe historike.
<p>Konkluzione:</p> <p>Programi i studimit MP Menaxhim Biznesi, profili: Menaxhim Arti është në përputhje me misionin dhe qëllimet e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, ka për qëllim formimin e të diplomuarve me baza të mira teorike dhe sens praktik për integrimin në tregun e punës në fushën e artit me synim zhvillimin e një aktiviteti në përputhje kërkesat aktuale e ato perspektive.</p> <p>Mendoj se ky standard në tërësi plotësohet. I vetmi shqetësim është përcaktimi i nevojave të tregut të artit i cili, siç u përmend më lart, përse i përket fushës së menaxhimit të artit është ende në fazë fillestare.</p>	
<p>Standardi I.2</p> <p>- Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit	Programi i studimit MP Menaxhim Biznesi, profili: Menaxhim Arti është hartuar duke patur në vëmendje arritjet e deritanishme në fushën e artit, angazhimin e institucioneve të tjera universitare brenda e jashtë vendit në këtë fushë, përvojën e tyre sa në mësimdhënje aq edhe në imazh, kërkesat e tregut të punës, evidentimin e

	<p>kontigjentit të interesuar, sigurimin e plotësisë në formatimin e planit mësimor, evidentimin e mangesive nëpërmjet krahasimeve me përvojat e të tjerëve dhe konsultimit të vlerësimeve nga studentët, realizimin e punës në grup të personelit akademik, ndihmës e administrativ etj. I gjithë ky aktivitet gjen shprehje në realizimin përfundimtar të planit mësimor dhe syllabuseve të cilat në tërësinë e tyre i gjejmë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p> <p>Mendoj se programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p>	<p>Mendoj se lëndët e programit të ciklit të dytë “Master i Arteve të Bukura” thellojnë njohuritë e studentëve duke u dhënë një bazë të shëndoshë teorike mbi strategjitë e marketingut si dhe një ndërthurje të teorisë me rastet e veçanta të vendimarrjes në situata konkrete biznesi të cilave, nëse u shtohen edhe aftësia analizuese dhe planifikuese kthehen në një garanci të mirëfilltë për të ardhmen e studentit si profesionit I fushës së manaxhimit të artit.</p> <p>Po ashtu jam i mendimit se lënda E drejta e Pronësisë Intelektuale në BE u jep, nëse shohim modulën e propozuar, vëmendjen e duhur koncepteve juridike të lidhura me të drejtën e mbrojtjes së krijimtarisë intelektuale dhe artistike si dhe kushtet që duhen plotësuar që të realizohet kjo pmbrojtje.</p> <p>Të domosdoshme janë mendoj edhe trajtimi dhe njohja e traktateve dhe marrëveshjeve në fuqi në Bashkimin Europian ku përgatitemi të hymë që lidhen me fushën e pronësisë intelektuale pasi në vendin tonë ende mbizotëron papërgjegjshmëria dhe shpërfillja e plotë e kësaj të drejte. Po ashtu e shoh të dobishme dhënien nga ana e këtij moduli të informacionit mbi historinë e të drejtës së pronësisë intelektuale pasi kjo me siguri ndihmon në ndërgjegjësimin e studentëve mbi këtë praktikë juridike dhe fazat nëpër të cilat ka kaluar konceptimi dhe përfshirja e normave që e mbrojnë këtë të drejtë në praktikën juridike europiane.</p> <p>Të një interesi të veçantë shoh edhe njohjen e studentëve me modulën e Marrëdhënieve me Publikun, një lëndë e cila përpunon dhe rafinon një prej vetive më të rëndësishme të një manaxheri arti, atë të komunikimit, ofron njohuri mbi teknikat e tij, etikën si element bazë I marketingut, si dhe përdorimin me efektshmëri të reklamës pa të cilën vështirë se mund të mendohet një menaxhim i suksesshëm i një biznesi artistik.</p> <p>I domosdoshëm për formimin e thelluar të një</p>

	manaxheri duket se është moduli Menaxhim Eventesh i cili e ndihmon studentin të hartojë një strategji biznesi, të planifikojë një buxhet racional dhe të mirëbalancuar duke shtuar mundësitë e suksesit.
Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;	Mendoj se programet e studimeve “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “master professional” duke u mbështetur në nivelin e arritur në ciklin e parë të studimeve arrijnë të ngrenë më lart nivelin profesional të studentëve.
Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;	Ky raport i vlerësimit të jashtëm është për Master Profesional në Menaxhim Biznesi, profili: Menxhim Arti.
Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;	Duket qartë se synimi i programeve studimore të ciklit të dytë është pajisja e studentëve me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale.
Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;	Mendoj se programet “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ofrojnë një bazë të qëndrueshme njohurish për ciklin e tretë të doktoraturës. Por theksoj mungesën e një numri orësh formuese mbi teorinë e artit, zhvillimet bashkëkohore në art. Pë rata student që nuk vijnë nga një shkollë arti ky formim mendoj se është i domosdoshëm.
Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	Të gjitha këto objektiva janë të qarta në arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me tregun e punës. Mendoj se objektivat janë të arritshëm dhe ndihmojnë në kualifikimin e studentëve dhe u përgjigjen kërkesave të tregut të punës.
Konkluzione: Si përfundim mund të themi se në modulet e propozuar në programin e studimeve të “Master i arteve të bukura” balancohet me efektshmëri teoria, kuadri ligjor me përgatitjen për praktikën manaxheriale në drejtimin e një biznesi në art për arsye që i parashtrua më lart. Kam vlerësime mjaft positive përveç një shqetësimi të cilin e ndava edhe me pedagogët e universitetit Mesdhetari: Mendoj se në programin e manaxhimit të artit duhet përfshirë edhe një lëndë me karakter teorik që lidhet me formimin estetik dhe njohuri mbi historinë e artit (përkatësisht për fushat që mendon të punojë) pasi nga kontaktet që kam patur me manaxherë të huaj në vitet e mëparshme ata njihnin mirë jo vetëm gjendjen e tregut të artit të fushës ku operonin, por kishin njohuri të mira edhe për historinë e artit dhe esteteikën në përgjithësi. Jam i mendimit se pa këtë përgatitje një manaxher do ta ketë të vështirë të funksionojë edhe si faktor kulturor, garantues i cilësisë dhe nivelit artistik të veprimtarisë apo biznesit që do të drejtojë.	
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	

<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p>	<p>Programet e studimit, të miratuara dhe në proces zbatimi, u përgjigjen kërkesave të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” (posaçërisht neneve 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30 të këtij ligji), si dhe kërkesave të Udhëzimit të MASH Nr.15 datë 04.04.2008 (posaçërisht krerëve VII, VIII dhe IX të tij). Gjithashtu, gjykoj se ato respektojnë standardet dhe kërkesat e Marrëveshjes së Bolonjës dhe reflektojnë zhvillimet dhe kërkesat aktuale e perspektive të tregut të punës në dimensione kombëtare, rajonale e ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Emërtimi i programit të studimeve MP Menaxhim Biznesi, profili: Menaxhimi Arti, është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
<p>Konkluzione: Jam i mendimit se dy kriteret e standardit I.3 plotësohen më së miri duke u përputhur si me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi ashtu edhe me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p>	<p>Programi i studimeve MP Menaxhim Biznesi, profili: Menaxhim Arti i pajis studentët me njohuritë e duhura për të kryer aktivitetin e tyre profesional në fushat e caktuara. Objektivat e vendosura në programet e lëndëve janë të realizueshme si nga përmbajtja ashtu edhe nga niveli i personelit akademik.</p>
<p>Kriteri 2 Metodën e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Këto metoda vlerësimi me anë testesh me përgjigje alternative përdoren sot gjerësisht kudo në universitetet europiane dhe prej kohësh e kanë treguar efektshmërinë e tyre, prandaj mendoj se përdorimi i tyre edhe në universitetin Mesdhetari janë të dobishme dhe do të japin rezultatet e duhura.</p>
<p>Konkluzione: Jam i mendimit se dy kriteret e mësipërme plotësojnë standardet bashkëkohore, si në rastin e përmbajtjes dhe renditjes së objektivave ashtu edhe në zgjedhjen e metodave të vlerësimit të studentëve.</p>	
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane</p>	<p>Po duket qartë, si e përmendëm edhe më lart që modelet ku janë mbështetur hartuesit e programeve janë marrë nga praktikat e suksesshme të arsimit universitar europian.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p>	<p>Mendoj se programet me elementet që përmbajnë afirmojnë vlerat e arsimit universitar në Shqipëri. Ky program studimi përmban element si studimi i legjislacionit europian lidhur me të drejtën e autorit, praktikën bashkëkohore të menaxhimit të artit.</p>

<p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Kjo kontribon jo vetëm në "lexueshmërinë" e programeve të studimit, por edhe në mundësinë e transferimit të krediteve e niveleve të studimit për në dhe nga universitete të tjera në Europë e më gjerë.</p>
<p>Konkluzione: Jam i mendimit se të tre kriteret e programet e studimeve jo vetëm synojnë arritjen e standardeve nëdrkombëtare por edhe ofrojnë një bazë të mirë studimi për arritjen e objektivave të përcaktuara në strategjinë e institucionit.</p>	
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të programit të studimit, vura re se është mirë që lëndët të pajisen në mënyrë sa më të plotë me ekspozimin e problematikave konkrete në seminare/ushtime dhe me shqyrtime konkrete të punimeve të pavarura të studentëve (kryesisht eseve) për të gjykuar mbi nivelin e tyre në kërkimin shkencor.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p>Programi i studimeve MP Menaxhim Biznesi, profili : Menaxhim Arti, është hartuar në përputhje me profilin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë dhe strategjinë e tij për zhvillim.</p>
<p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Gjatë takimeve të realizuara me personelin akademik, konstatova se ndihmesa e tyre për kërkimet shkencore, mbështetja për pjesmarrje në takimet shkencore dhe stimulimi i publikimeve shkencore janë tre zëra që konsiderohen me përparësi në buxhetin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Megjithatë duhet të merren në konsideratë shtimi i kontakteve me universitet e këtij profili për të lidhur marrëveshje për të shkëmbyer përvojën dhe metodikën e tyre.</p>
<p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Në personelin akademik të angazhuar në programin e studimeve MP Menaxhim Biznesi, profili : Menaxhim Arti ka një përvojë të qartë në fushën e menaxhimit të artit. Kjo përvojë është një garanci më shumë për ngritjen e nivelit të tyre personal dhe përballimit në të ardhmen të detyrave me të cilat do të përballen me zbatimin në terren të njohurive të fituara.</p>
<p>Konkluzione: Mbështetja e procesit mësimor nga një veprimtari kërkimore në rritje kontribon në rritjen e cilësisë së përgatitjes së studenteve dhe në zhvillimin e kapaciteteve të tyre krijuese. Vlerësoj që duhet punuar më mirë në inkurajimin e studentëve për t'iu bashkangjitur aktivitetit kërkimor të personelit akademik pasi ata janë në fillimin e rrugës së tyre.</p>	
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p>	<p>Mendoj se niveli i programit është i mirë por është vështirë të flasësh në këtë rast për një treg të mirëfilltë për menaxhimin e artit në sektorin privat pasi biznese të tilla ose nuk ekzistojnë fare, galeri arti, trupa teatrore private, orkestra etj. ose operojnë në nivele fare të ulta kulturore.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Kam të njëjtin vlerësim të shprehur për standardin I.7,1.</p>
<p>Konkluzione: Mendoj se programet kanë nivelin e duhur, por nuk kanë se çfarë nevojash të mbajnë parasysh për sektorët përkatës pasi duke përjashtuar sektorin publik (me institucionet e tij që përdorin fonde publike dhe shumica vegjetojnë përsa i përket marketimit dhe manaxhimin të burimeve të tyre) sektori që duhet vërtet të përdorë këto njohuri do të ishte ai privat, pasi aty kërkohet një përdorim racional i burimeve financiare dhe hartimi i politikave dhe strategjive të duhura përndryshe nuk mund të mbijetosh në treg. Por ky sektor të paktën për momentin që flasim pothuaj nuk ekziston.</p>	
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p>	<p>Cilin treg pune në fushën e artit pasi me sa dimë nuk ka ndonjë studim ku të përfshihet edhe ky treg, ndoshta për shkak të peshës së papërfillshme në ekonominë e vendit.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Në raportin e paraqitur nga UMSH nuk pashë ndonjë studim të tregut të punës që lidhet me fushën e artit, prandaj nuk kam dijeni për ndonjë vlerësim të lidhur me pikat a,b, c.d.</p>
<p>Konkluzione: Ky standard përmban të njëjtën problematikë me standardin I.7 prandaj mendoj se vlerësimet e tij vlejnë edhe për këtë standard.</p>	
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtarë;</p>	<p>Programi i studimit kontribon direkt në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për integrimin e sistemit universitar shqiptar në atë europian si dhe në përfshirjen rajonal të punës të menaxhimit të artit.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Pas verifikimit të materialit për këtë program studimi, del qartë se programi respekton hapur ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p>Konkluzione: Mendoj se dy kriteret e mësipërme arrijnë nivelin e kërkuar.</p>	
<p>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e</p>	

programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Po, jam i këtij mendimi. Të gjitha metodat e përshkruara në raportin e UMSH-së janë metoda standard bashkëkohore që garantojnë mbarëvajtjen e programeve të studimeve.
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	Mbështetur në raportin e vetëvlerësimit, në këtë Institucion, sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe ka funksionon me të gjitha strukturat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Kështu në nivel njësie bazë siç është departamenti analizohen programet mësimore, literatura, sistemet e vlerësimit para çdo fillimi të vitit të ri akademik dhe në vazhdim të tij. Konstatohet se janë institucionalizuar elementë të sistemit të sigurimit të cilësisë, është ngritur dhe funksionon një sistem i plotë i dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij, në përputhje me standardet përkatëse.
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	Po personeli shoqëruar i UMSH-së na tregoi botime ku tregoheshin rezultatet dhe objektivat që kërkon të arrihen nga ky institucion.
Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: <u>Të tërthorta:</u> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <u>Të drejtpërdrejta:</u> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); 	Sipas RVB, në kuadrin e krijimit të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë UMSH përdor metodologjinë e mëposhtme: konsulta me trupën akademike, ekspertë të jashtëm dhe studentë, krahasimin me ecurinë e programeve të ngjashme të studimeve në universitetet e tjera të vendit dhe të huaja. UMSH është i angazhuar në vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit duke përdorur instrumenta të tillë si: pyetsorët e strukturuar me pyetje konceptuale për studentët që ndjekin programet, të diplomuarit, pedagogët, ekspertët e punëdhënësit në vlerësim të didaktikës, kurrikulës, rezultateve etj. Përpos këtyre zhvillohen edhe intervista, teste të standartizuara, dëgjime në auditor, vlerësimi me nota (pikë), testimet paraprake e përfundimtare, vlerësim detyrash, vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave/ushtimeve. Prania e një kulture institucionale të vlerësimit kritik të vetvetes nëpërmjet organizimit të vlerësimeve të brendshme dhe planifikimit të përmirësimeve të nevojshme, që GVJ e gjeti të shprehur në prova dokumentare, janë garanci për qasjen objektive të institucionit ndaj menaxhimit të cilësisë tani e në të ardhmen. Nga bisedat me pedagogët del qartë se institucioni i përdor rregullisht qysh nga fillimi i tij si metodat e tërthorta ashtu edhe ato të drejtpërdrejta të vlerësimit.

<p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	
<p>Konkluzione: Jam i mendimit se Universiteti Mesdhetari përdor metodologji të përshtatshme vlerësimi, dhe instrumentat e duhur matës të ecurisë së programeve të studimeve; dhe përdor rregullisht si metodat e tërthorta ashtu edhe ato të drejtpërdrejta të vlerësimit.</p>	
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Në RVB përcaktohet që me përfundimin e procesit mësimor në vitin 2011-2012, duke u bazuar në rezultatet e arritura, do të hartohet një plan strategjik në rang institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët, apo institucionet me të cilat bashkëpunohet.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Nga RVB bëhet e qartë se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë synon në arritjen dhe mbajtjen e standarteve të larta akademike në përputhje me misionin e Universitetit. Elementë kyç të këtyre parimeve përfshijnë qartësinë dhe saktësinë e përcaktimit dhe komunikimit të standardeve akademike të Universitetit nëpërmjet proceseve të tilla përcaktimi i kërkesave të qarta për rekrutimin e stafit akademik, për mbështetjen e tij me programe kualifikuese, përdorimin e metodave të larmishme të mësimdhënies, proceset gjithëvjetoare dhe shumëplanëshe të vlerësimit të, sistemeve të administrimit të dokumenteve, etj.</p>
<p>Konkluzione: Shikohet qartë se Institucioni ka një vizion të qartë për përmirësimin e programeve të studimeve në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët, apo institucionet me të cilat bashkëpunohet.</p>	
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Ky raport është për programin e studimit Master Profesional.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi i studimeve MP menaxhim Biznesi, me profili : Menaxhim Arti realizohet me 60 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja e tij është një vit akademik.</p>

<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Ky raport është për programin e studimit Master Profesional.</p>
<p>Konkluzione: Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programin e studimeve MP Menaxhim Biznesi, profili: Menaxhim Arti, janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p>	<p>Nga raporti i paraqitur del se UMSH-ja ka programuar botimin e materialeve informuese në ndihmë të vlerëimit të brendshëm të cilat do t’u bëhen të njohura të studentëve, pedagogëve, ekspertëve dhe kolegëve të universiteteve të tjera publike dhe private si dhe eksperëtve të tregut të punës.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Materialet informuese në ndihmë të vlerëimit të brendshëm janë pjesë e faqes zyrtare të UMSH-së, http://ëëë.umsh.edu.al/.</p>
<p>Konkluzione: Nga materialet e ofruara del se institucioni boton informacion në përputhje me kërkesat që ka vlerësimi i brendshëm dhe në faqen e tij zyrtare prezanton publikisht këto informacione.</p>	
<p align="center">II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT BËHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE.</p>	
<p>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p>	<p>Personeli nga kontaktet që patëm dukej i angazhuar dhe i motivuar në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre.</p>
<p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli nga kontaktet që patëm dukej i angazhuar dhe i motivuar në përputhje me strategjinë e programit të studimit dhe për arritjen e tyre.</p>
<p>Konkluzione: Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ janë të angazhuar për përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</p>	
<p>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit themelor të UMSH, del e qartë se strategjia e tij është përqendruar në mësimdhënie, kërkimin shkencor</p>

	<p>dhe kontributin për shoqërinë.</p> <p>Misioni i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës. Qëllimi i UMSH është ndërtimi i një komuniteti mësimi dhe krijimi në të cilin respektohet, vlerësohet dhe besohet cdo pjestar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për vehten dhe të tjerët nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës.</p> <p>UMSH është i organizuar dhe operon si një Institucion i Arsimit të Lartë i cili ofron programe studimi të nivelit bachelor, MP dhe Msc.</p>
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	Ky kriter plotësohet pasi janë tre fakultete: Ai I Shkencave ekonomike, Fakulteti I Marrdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë dhe Fakulteti I Shkencave Politike.
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	Në UMSH cdo fakultet përbëhet nga së paku 2 departamente, nga raporti del se edhe ky kriter përmbushet plotësisht.
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike përbëhet nga 2 departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Finance Banked he Kontabilitet • Departamenti i Menaxhimit
Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".	<p>Personeli akademik i angazhuar në programet e studimit të ciklit të dytë ka minimalisht gradën shkencore "Doktor".</p> <p>Personeli akademik i angazhuar plotëson kriterin e titujve të nevojshëm dhe për funksionim normal të programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - 4 Dr. - 3 Prof. Dr
Konkluzione:	
Jam plotësisht dakord me mendimin se të 5 kriteret e parashtruar më sipër garantojnë se institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	
Standardi II.3	
- Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;	Në mbështetje të Statutit dhe rregullores të UMSH (neni 27 dhe 28 i statutit) departamentet dhe fakultetet angazhohen drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë aktive në realizimin e programit të studimeve nëpërmjet përfshirjes edhe të pedagogëve përkatës
Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.	Në mbështetje të Statutit dhe rregullores të UMSH (neni 36 dhe 37 i statutit) departamentet dhe fakultetet angazhohen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij nëpërmjet përfshirjes edhe të pedagogëve përkatës.
Konkluzione:	

<p>Realizimi i programi të studimit është përgjegjësi e fakultetit dhe departamentit të cilët bëjnë koordinimin e punës për mbulimin e plotë të aktiviteteve të parashikuara në program si dhe vlerësimin e aktivitetit të punonjësve akademikë. Jam i mendimit se njësitë bazë dhe kryesore janë në lartësinë e përgjegjësive që kanë marrë përsipër.</p>	
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p>	<p>Besoj se angazhimi i personelit akademik luan rolin e tij të pazëvendësueshëm në hartimin e kurrikulave dhe është pjesë e vendimmarrjes që lidhet me organizimin e programeve të studimeve.</p>
<p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Mendoj se në këtë rast zbatohen kërkesat dhe standardet e Ligjit të Arsimit të Lartë Nr.9741, Udhëzimet e MASH, nenet 36 dhe 37 të Statutit dhe Rregullorja e Universitetit neni 27 që rregullojnë rekrutimet dhe ngarkesën.</p>
<p>Konkluzione: Mendoj se edhe ky standard realizohet brenda kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore.</p>	
<p>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p>	<p>Si vendndodhja e godinës së marrë me qira ashtu edhe infrastruktura, niveli i shërbimeve dhe standardeve ofrojnë kushte maksimale për mbarëvajtjen e mësimit dhe kërkimit shkencor. Janë të paktë universitetet që mund t'u sigurojnë studentëve kushte të tilla.</p>
<p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p>	<p>Nënshkrimi i kontratës për një periudhë dhjetëvjeçare plotëson edhe këtë kriter.</p>
<p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>Me sa di deri tani universiteti ka vetëm një godinë dhe ky kriter vlen për të ardhmen nëse universiteti do të bëjë ndonjë zgjerim të mundshëm.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Vlerësoj maksimalisht nivelin dhe cilësinë e mjediseve dhe kapaciteteve për realizimin e praktikave profesionale. Gjatë vizitës tonë pamë pjesëmarrjen e dy prej studentëve të UMSh-së në një telekonferencë, fakt që tregon si për shkallën e lartë të kontakteve të UMSh-së me insitucione të ngjashme jashtë vendit ashtu edhe me nivelin e mirë të studentëve tij të cilët janë në gjendje të përballojnë pjesëmarrje të tilla pa asnjë vështirësi.</p>
<p>Konkluzione: Si vendndodhja e ndërtesës, mjediset e brendshme, pajisja e tyre me infrastrukturën e nevojshme ofrojnë kushte maksimale për mbarëvajtjen e mësimit dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p>	<p>Për programin e studimit ekzistojnë modulet dhe syllabuset përkatëse të përgatitura nga pedagogët përkatës. Ato ishin të aksesueshme prej studentëve kryesisht në formën off line. Është programuar që brenda një afati të shkurtër të</p>

	realizohet edhe aksesimi i tyre on line.
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Këtë e vërtetojmë nga kontaktet me stafin shoqëruar, ku modulet dhe syllabuset ofrohen në disa forma, si offline dhe botime të formateve të ndryshme.
Konkluzione: Nga ajo që pamë në mjediset e universitetit duke qartë që studentëve u ofroheshin mundësi dhe lehtësi të shumta në konsultimin e informacionit që lidhej me programet, modulet dhe syllabuset dhe ofrohej nme teknologjinë bashkëkohore të informimit.	
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	UMSH ka programuar të kryejë analizën vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të ciklit të dytë në muajin korrik 2012
Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	Sipas RVB UMSH është e angazhuar të bëjë përmirësime për ciklin e dytë të studimeve duke marrë në konsideratë: konsultimin e programeve me programe analogë të universiteteve përëndimore, universiteteve publike e private në vend, ekspertiza të ekspertëve të huaj të arsimit universitar dhe parauniversitar, ekspertiza të ekspertëve të arsimit universitar e parauniversitarë në vend, konsultimin me student, konsultimin me politikbërës dhe menaxherë të sistemit arsimor universitar dhe konsultimin me ekspertë të tregut të punës.
Konkluzione: Programi i studimit është në vitin e parë të proves dhe Institucion shpreh se do të angazhohet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe sipas detyrave të parashikuara të programit të studimit.	
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Parashikohet të realizohet me fillimin e studimeve të semestrit të fundit, individualisht për çdo student, nëpërmjet bashkëpunimit të tyre me drejtuesin e zgjedhur, ku do të përcaktohen periodat kohore dhe axhenda konkrete.
Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Për realizimin e programit të studimeve MP Menaxhim Biznesi, profili: Menaxhim Arti parashikuar 8 kredite për përgatitjen e mikrotezës dhe 25 orë në auditor konsultime.
Konkluzione: Të dy këto kritere përmbushin kërkesat që shtrohen përpara një universiteti bashkëkohor si ato që lidhen me mënyrën e diplomimit ashtu edhe me numrin e krediteve të parashikura për projektin mësimor dhe tezën.	
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	UMSH disponon dhe menaxhon burime financiare. Për çdo vit hartohet një raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Auditimi i jashtëm ktyhet nga studio AIEI Auditors Zyra e Financës administron të gjithë informacionin e nevojshëm mbi pagesën dhe çështjet e financiare

	që i interesojnë stafit dhe studentëve të UMSH.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Tek të ardhurat vend të veçantë zenë ato që e kanë burimin nga sponsorët e ndryshëm si dhe nga tarifat e studentëve. Raporti i auditit të kryer nga AIEI Auditors përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë (Sipas RVB).
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Në raportin e auditit të kryer nga AIEI Auditors paraqitet dhe analizohet efica e të ardhura nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve (Sipas RVB).
Konkluzione: UMSH disponon dhe menaxhon burimet financiare dhe harton një raport vjetor financiar mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Ato çertifikohen nga auditimi i jashtëm dhe vihen në dispozicion të investimeve në infrastrukturë, procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Për programet e ciklit të dytë pra edhe për programin e studimeve MP Menaxhim Biznesi, profili : Menaxhim Arti nuk ka akoma një raport pasi akoma nuk është mbyllur viti i parë.	
III - PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA PERSONELI AKADEMIK, PERSONELI NDIHMËS MËSIMORSHKENCOR DHE PERSONELI ADMINISTRATIV.	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Bazuar në statutin e UMSH-së, neni 36 dhe 37 personeli i UMSH-së përbëhet nga shtetas shqiptarë osë të huaj të cilët grupohen sipas profilit të punës në kategoritë e mëposhtme: Personel mësimor shkencor, personel ndihmës mësimor shkencor, personel administrative dhe personel shërbimi. Në politikat e punësimit respektohen: raporti i personelit akademik i brendshëm dhe i jashtëm përkundrejt studentëve do jetë 1:8, raporti i personelit ndihmës, administrative dhe i shërbimit përkundrejt personelit akademik dhe numrit të studentëve do zërë peshën e 20 deri 39%. Procesi i rekrutimi të stafit akademik nis me propozimin e departamentit i cili përcakton kriteret që duhet të plotësojë kandidati. Dekani/drejtori pas ii verifikon paraprakisht dhe bie dakord me to , i përcjell në rektorat për miratim dhe për ndjekje të mëtejshme të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës. Njoftimet publikohen në gazeta, revista apo televizione. Domosdoshmërisht ato duhet të publikohen në faqen zyrtare të universitetit së bashku me formularët e aplikimit. Paketa e aplikimit të cdo kandidati duhet të përmbajë: formularin e aplikimit, tri letra rekomandimi nga pedagogë apo udhëheqës shkencorë dhe së paku njëra nga tri letrat duhet të jetë nga punëdhënësi/drejtuesi nqs ka, fotokopje të noterizuar të diplomës, fotokopje të noterizuar të certifikatës së notave, fotokopje të noterizuara

të dëshmvive të kualifikimit, fotokopje të artikujve shkencorë të publikuar në revista ndërkombëtare profesionale/shkencore, fotokopje të pasaportës ose një dokumenti identifikimi dhe programin/et (syllabuset) e lëndë/ve për të cilën/at ai kandidon. 70% të peshës së vlerësimit e ka paketa e aplikimit dhe 30% intervista. Aplikimet merren në dorëzim me procesverbal nga njësia përkatëse e UMSH jo më vonë se 5 ditë nga afati i mbylljes së tyre. Kjo listë afishohet në ambientet e universitetit . Dekanët e sejcilit fakultet paraqesin në rektorat përbërjen e komisione të vlerësimit të kandidaturave për sejcilin specialitet të cilët hartojnë listën e kandidaturave sipas pikëve të fituara në rendin zbritës dhe e paraqesin atë pranë dekanit. Të gjithë kandidatët njoftohen për datën dhe orën e provimit me shkrim me shkresë zyrtare (postë) dhe me E-mail. Ky njoftim publikohet në ambientet e universitetit. Dekani në bashkëpunim me rektoratin, duke u bazuar në rezultatet e marra nga vlerësimi përcaktojnë kandidatët që do intervistohen. Listën përfundimtare të kandidatëve që do intervistohen e vendos rektorati. Kjo listë publikohet në vende të dukshme të fakulteteve përkatëse nga komisionet e pranimit. Kandidatët njoftohen për intervistën me shkrim me shkresë zyrtare (postë) dhe me E-mail. Pas përfundimit të intervistës, komisioni për vlerësimin e kandidaturave harton një listë ku vendosen pikët e grumbulluara në intervistë për sejcilin kandidat. Në përfundim të shqyrtimit të paketës së aplikimit dhe intervistës komisionet për vlerësimin e kandidaturave plotësojnë formularin përmbledhës dhe mbyllin të gjithë dokumentacionin për sejcilin kandidat. Lista përfundimtare diskutohet në rektorat ku merret vendimi për kandidatin fitues. Kandidatët jofitues njoftohen me –mail dhe me letër zyrtare. I gjithë dokumentacioni protokollohet dhe ruhet në rektorat dhe fakultet. E njëjta procedurë ndiqet dhe personelin ndihmës mësimor shkencor me specifikën që në vend të fotokopjeve të punimeve shkencore dhe programit e syllabuseve kërkohen librezat e punës dhe dëshmia e penalitetit. Me pak specifika procedura ndiqet edhe për personalin administrative dhe atë të shërbimit.

Për plotësimin e nevojave në procesin mësimor UMSH realizon kontrata edhe me personelin akademik me kontratë të përkohshme dhe me atë të ftuar kërkesa për të cilët bëhet nga njësiti kryesore ndërsa numri përcaktohet nga rektorati. Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat që vijnë: të kenë zotësi të plotë për të vepruar, të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale dhe akademike për vendin e punës për të cilin kërkohen, të mos

	<p>jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e nje vepre penale me dashje dhe të kenë notë mesatare të lartë të studimeve. Kriteria më specifike përcaktohen në rregulloret e brendëshme të njësive kryesore. Të drejtat dhe detyrat e të gjithë personelit sipas grupimeve të përmendura disiplinohen në kontratat e punë që lidhen midis tyre dhe institucionit (Sipas RVB).</p>
<p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p>	<p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën 75% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p>	<p>Kostatoj një angazhim korrekt në drejtim të ndjekjes së procedurave ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në mënyre institucionale janë përcaktuar kriteret për vlerësimin e aktiviteteve akademike të personelit akademik dhe të kandidatëve për t'u përfshirë në personel akademik. • Në fakultete është i programuar procesi i marrjes së feedback-ut nga studenti.
<p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Problematika e mbajtjes së një baze të dhënash në UMSH lidhet me problematikën e menaxhimit të informacionit në këtë institucion, i cili shpërndahe duke përdorur kanalet e mëposhtme:</p> <p><u>Verbal:</u> Të gjitha zyrat janë përgjegjëse për të dhënë informacion të detajuar mbi Universitetin, aktivitetet e departamenteve, gjithashtu ruajnë integritetin dhe konfidencialitetin e institucionit në çështje specifike.</p> <p><u>Me shkrim:</u> Informacioni me shkrim lëshohet me kërkesë të personit në fjalë ose për shkak se çështja është e lidhur me studentë të veçantë, anëtarë të stafit akademik ose njësi universitare.</p> <p><u>Elektronike:</u> Informacioni është i shpërndarë duke përdorur ëebmail, në këtë kontekst baza e të dhënave e-mail-i është mbajtur e përditësuar.</p> <p>Në mënyrë të veçantë, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe rekrutimit administron dosjet që përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të Universitetit, si dhe menaxhon të dhënat mbi stafin.</p>
<p>Konkluzione:</p> <ul style="list-style-type: none"> • UMSH ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. • Janë përcaktuar kriteret për vlerësimin e aktiviteteve akademike të personelit akademik dhe të kandidatëve për t'u përfshirë në personel akademik. • Respektohen kërkesat për raportet staf akademik me kohë të plotë dhe staf akademik me kohë të pjesshme si dhe shkalla e kualifikimit e kërkuar. • Zyra e Burimeve Njerëzore dhe rekrutimit administron dosjet që përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, si dhe menaxhon të dhënat mbi stafin. 	

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;	Përgjegjësi i që mbulon programin e studimit ka gradën PHD të fituar në universitetet perëndimore
Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Nga raporti i vlerësimit të brendshëm del s titullari i lëndëve/modulit në programin e studimit ka të paktën gradën shkencore “Doktor”.
Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;	Zhvillimi i lëndëve/moduleve në programin e studimit mbulohet nga një personel akademik i cili minimalisht zotëron gradën shkencore “Doktor”.
Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;	Drejtuesit e institucionit, njësive kryesore dhe njësive bazë si dhe përgjegjësi i programit të studimeve janë të punësuar me kohë të plotë në UMSH.
Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	Stafi i angazhuar pranë UMSH plotëson kërkesat për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale
Konkluzione: Personeli akademik i angazhuar për mbulimin e programit të studimit ka kualifikimin e duhur. Zhvillimi i të gjitha aktiviteteve, përfshirë edhe praktikave profesionale, mbështetet e realizohet kryesisht nga personel akademik dhe ndihmës me kohë të plotë.	
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;	Nga kontaktet që patëm me drejtuesit e institucionit u siguroam se i gjithë personeli akademik boton rregullisht në shtypin vendas dhe të huaj material shkencore në disipinën përkatëse dhe janë të pranishëm edhe në median vendase në biseda apo intervista ku japin ndihmesën e tyre në trajtimin e këtyre çështjeve duke propozuar zgjidhjet e tyre.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Jam i sigurt që e gjithë kjo veprimtari është një ndihmesë e çmuar në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo shërbimit në vend.
Konkluzione: Duket qartë që në këtë universitet i jepet një rëndësi e madhe angazhimit të personelit akademik në jetën shkencore dhe kulturore të vendit përmes botimeve të artikujve, studimeve në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe në median vendase.	
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik	

të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;	Në rregullore kjo përcaktohet qartë.
Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Personeli akademik mendoj se përvojën e duhur për tu angazhuar në procesin e mësimdhënies në gjuhë të huaj.
Konkluzione: Këto kritere të domosdoshme të cilat zgjerojnë përvojat e mësimdhënies me të cilat përballen studentët dhe padyshim i pasurojnë ato plotësohen me këtë kriter i cili mendoj se është në nivelin e kërkuar për të përmbushur qëllimin e tij.	
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;	Edhe për studentët që ndjekin programin e studimit, për semestrin e fundit janë programuar udhëheqës për punën kërkimore të cilët me propozimin e vetë studentëve dhe në bashkëpunim me to do të harrojnë planin e diplomimit i cili do përmbajë periudhat kohore dhe çështjet konkrete.
Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Edhe për studentët që ndjekin programin e studimit, për semestrin e fundit janë programuar udhëheqës për punën kërkimore që do të kenë së paku gradën “Doktor”
Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.	Në materialin e ofruar nga universiteti bëhet e qartë se udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 studentë njëkohësisht dhe më shumë se 10 studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore dhe humane. Mendoj se ky kriter është i domosdoshëm për të ruajtur nivelin e cilësisë së drejtimit të studentëve.
Konkluzione: Mendoj se edhe ky standard plotësohet pasi vihet qartë theksi mbi rëndësisinë e drejtimit nga një udhëheqës kërkimi, përgatitjen e tij profesionale si dhe ngarkesën e tij e cila nëse tejkalohet do të rëndonte detyrimisht mbi nivelin e drejtimit të studentëve dhe mundësinë e tij për të kontrolluar ecurinë e tyre deri në përfundimin dhe dorëzimin me sukses të temës.	
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.	Duke ju referuar RVB konstatohet që është programuar që udhëheqësit të angazhohen në fusha studimore-kërkimore në të cilën janë specializuar.
Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	Duke ju referuar RVB udhëheqësit do të caktohen të tillë që të kenë njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

<p>Konkluzione: Për programin e studimit MP Menaxhim Biznesi, profili: Menaxhim Arti, ka një personel akademik me kualifikim të lartë i cili mbulon drejtimet e propozuara të programeve të studimit e në mënyrë të veçantë përgatitjen e tezës.</p>	
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p>	<p>Këtë fakt ne e konstatuam gjatë vizitës tonë në UMSH. Është e vërtetë që personeli ndihmës mësimor-shkencor ishte tërësisht i angazhuar. Kjo dukej në gatishmërinë e mejteve të cilat funksiononin më së miri por edhe në organizimin racional të pajisjeve në hapësirën e mejdseve në zotërim.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga kontaktet me personelin krijuam pikërisht këtë përshtypje, që burimet njerëzore të universitetit përdoren me racionalitet me qëllim përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>
<p>Konkluzione: Gjatë vizitës tonë në UMSH konstatuam fare lehtë angazhimin maksimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor, disiplinën e tyre në punë dhe ndihmën që jepnin në mirëmbajtjen e mjediseve. Po ashtu konstatuam se institucioni përdor mjaft mirë burimet njerëzore në dispozicion për të arritur objektivat e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p>	<p>Vlerësoj se ngarkesa mësimore realizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. (Ligji i Arësimit të Lartë Nr.9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar në Ligjin 19 307 datë 22.7.2010. Udhëzimet e MASH, nenet 36 dhe 37 të Statutit dhe Rregullorja e Universitetit neni 27 që rregullojnë rekrutimet dhe ngarkesën).</p>
<p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Ngarkesa mësimore dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë vlerësohen me orë mësimore.</p>
<p>Konkluzione: Ky standard i domosdoshëm që respekton të drejtën e pedagogut të mos ngarkohet më shumë se nga sa e parashikojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi vendos para tyre gjithashtu detyrimin për të përmbushur numrin e caktuar të orëve u përmbahet sit ë drejtave ashtu edhe detyrimeve të personelit akademik.</p>	
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p>	<p>Në UMSH pamë që institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik dhe personave të tjerë përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Rekrutimit administron dosjet që përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të UMSH, si dhe menaxhon dhe vazhdimisht përditëson të dhënat</p>

	mbi stafin e Universitetit.
Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;	Menaxhimi i aktivitetit mësimor kryhet nga sekretaria mësimore në bashkëpunim me Departamentin përkatës. Zyra e Burimeve Njerëzore disponon listën e plotë të personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për secilin semestër
Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	Procesi i rekrutimi të stafit fillon me kriteret e përcaktuara nga departamenti, i cili shpall vendet e lira, llojin e vendit të lirë (me kohë të plotë ose të pjesshme), si dhe të gjitha karakteristikat dhe kushtet e tjera të nevojshme që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për një vend të lirë pune, në të cilin kërkohet titulli Doktor, Docent, Profesor i Asociuar dhe Profesor. Në të njëjtën kohë, procedurat dhe data e mbylljes së aplikimeve shpallen në mënyrë të qartë. Miratimi përfundimtar bëhet nga Rektorati. Procedura është ligjore dhe transparente
Konkluzione: Universiteti disponon një sistem informacioni i cili ndërmjet të tjerash realizon edhe menaxhimin e informacionin për personelin.	
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtijshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtijshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;	Nga pyetjet që u drejtuam personelit dhe pedagogëve ata pohuan pikërisht faktin se institucioni organizon programe të tilla që u vlejnjë për ngritjen e nivelit të mësimdhënies dhe të nivelit të tyre shkencor në disiplinat përkatëse.
Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtijshme brenda dhe jashtë vendit.	Institucioni bën përpjekje të vazhdueshme edhe në këtë drejtim.
Konkluzione: Në UMSH I kushtohet një vemëndje e veçantë si organizimit të programeve të kualifikimit për personelin akademik dhe atij mësimor-shkencor ndërkohë që institucioni përpjeket t' u krijojë të gjitha mundësitë për thellimin e njohurive në institucione brenda dhe jashtë vendit.	
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Institucioni ka filluar të dokumentojë të dhënat e studimeve shkencore të personelit akademik.
Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Po ashtu ka filluar të mbledhë të dhëna për të gjitha botimet brenda dhe jashtë vendit të personelit akademik.
Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	UMSH-ja ka filluar gjithashtu ngritjen e një baze të dhënash mbi të gjitha projektet shkencore brenda dhe jashtë vendit ku ka marrë pjesë personeli i tij akademik.

<p>Konkluzione: Gjatë vizitës pamë se UMSH-ja ka filluar të ngrejë një bazë të dhënash ku përfshihen si studimet shkencore të personelit akademik dhe atij mësimor - shkencor, botimet e ndryshme të personelit akademik ashtu edhe të gjitha projektet ku kanë marrë pjesë si personeli akademik. Ky standard është i domosdoshëm për të dokumentuar në vite si nivelin e personelit akademik ashtu edhe shkallën e pjesëmarrjes së personelit të tij në projekte të ndryshme duke dhënë kështu ndihmesë të çmuar në zhvillimin e vendit.</p>	
<p>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</p>	
<p>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p>	<p>Sipas RVB studentët që ndjekin programin e studimit MP Menaxhim Biznesi, profile: Menaxhim Arti janë të detyruar të kenë në zotërim të paktën diplomën Bachelor dhe të kene grumbulluar 180 kredite ECTS. Në statutin dhe rregulloren e UMSH janë përcaktuar kriteret e pranimit dhe transferimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve.</p>
<p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p>	<p>Kjo bëhet e qartë në materialin e paraqitur nga UMSH-ja</p>
<p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p>	<p>Studentët i plotësojnë këto kriteret.</p>
<p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve; Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë kriter: provimi i gjuhës angleze mbi bazën e testeve ndërkombëtare, dhe niveli i dytë C1 janë pjesë e vlerësimit dhe më duket me vend këmbëngulja e institucionit që të vlerësojë herë pas here politikën e pranimit dhe të hartojë plane për ndryshimin sipas nevojave të kriterëve të pranimit.</p>
<p>Konkluzione: Standardi IV.1. përmban kërkesa të domosdoshme ku përcaktohen si formimi i caktuar për të hyrë në programet e nivelit të dytë, i cili siç theksohet duhet bërë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, e vë theksin në mënyrën e duhur mbi detyrimin e plotësimit të kriterëve nga studentët dhe sidomos në njohjen dhe zotërimin të testuar sipas programeve të njohura ndërkombëtarisht të gjuhës angleze. Me interes më duket edhe fakti që institucioni parashikon që këto kriteret të ndryshojnë herë pas here në përputhje me kërkesat e kohës.</p>	
<p>Standardi IV. 2 - Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p>	<p>Informacioni ekzistues është i formës së përgjithshme, por mungojnë informacione më specifike në lidhje me shërbimin e këshillimit të karrierës</p>

Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky insttucion;	Studentët njoftohen rregullisht mbi ecurinë e akreditimit të institucionit dhe vlerën e diplomës së tij në tregun e punës si brenda ashtu edhe jashtë vendit.
Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.	Institucion mendon ta përmirësojë nivelin e dhe gamën e informacionit që do tu ofrohet studentëve nga ky shërbim.
Konkluzione: Nga informacionet që mblodhëm gjatë vizitës në UMSH doli qartë se studentëve u jepet informacion si për mundësitë e punësimit pas diplomimit ashtu edhe për akreditimin dhe vlefshmërinë e diplomës brenda dhe jashtë vendit.	
Standardi IV. 3 - Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;	Duke qenë universitet i ri mbetet që kjo statistikë të fillojë shumë shpejt të krijohet. Akoma nuk ka përfunduar një cikël studimesh në nivelin e dytë. Pritet që diplomimi i parë të bëhet në vitin akademik 2011-2012
Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;	Këto statistika mbahen rregullisht. Sekretaria mësimore dhe pranimet disponojnë të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar në Programet e nivelit të dytë, tërheqjet nga programet si dhe largimet
Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.	Ecuria akademike e studentëve ndiqet me kujdes nga personeli i ngarkuar me këtë detyrë.
Konkluzione: Duke qenë institucion arsimor i cili ende nuk ka nxjerrë të diplomuarit e parë kjo mbetet të bëhet në vitet në vazhdim, por përsa u përket statistikave vjetore të numrit të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të dytë, apo largimet pa e përfunduar këtë program si dhe ndjekja e ecurisë së tyre akademike, këto monitorohen dhe eregjistrohen me kujdes nga personeli i ngarkuar për këtë qëllim.	
Standardi IV. 4 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;	Kjo mbetet për t'u bërë në të ardhmen pasi ky program studimi ende nuk ka përfunduar.
Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.	Kjo mbetet për t'u bërë në të ardhmen pasi ky program studimi ende nuk ka përfunduar.
Konkluzione: Mendoj se për shkak se UMSH-ja ende nuk ka nxjerrë një brez të diplomuarish të gjitha këto kritere mbetet të plotësohen në të ardhmen.	
Standardi IV. 5 - Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me	

programet e studimeve.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;	Kjo bëhet rregullisht nga personeli ose përmes mjeteve të informimit të universitetit.
Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;	Studentët informohen rregullisht. Sekretaria mësimore dhe pranimet është e ngarkuar të informojë studentët mbi rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit.
Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	Nisur nga fakti që ky program studimi ende nuk ka përfunduar, akoma nuk është realizuar ndonjë vlerësim përfundimtar i cili do të plotësonte këtë kriter. Megjithatë mbetem me besimin se përgjegjësi i modulit do të diskutojë hapur me studentët e tij.
Konkluzione:	
Standardi IV. 6	
- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	Në UMSH është ngritur Zyra e Këshillimi të Karrierës, e cila i informon studentët për programet e studimit që ofron UMSH, për mundësitë që ekzistojnë për studime në nivelin e dytë si në UMSH ashtu edhe në universitetet e tjera brenda e jashtë vendit, mundësitë e punësimit si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë rajonal e më gjërë, gjendjen e akreditimit të institucionit dhe programeve të studimeve.
Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Zyra për këshillimin e karrierës u jep ndihmë studentëve për problemet që lidhen me ushtrimin e praktikës profesionale.
Konkluzione:	
Institucioni, në përputhje me kërkesat që shtrohen përpara çdo universiteti europian të kohës kujdeset që studentëve t'u ofrohet si informacioni ashtu edhe ndihma përmes këshillave të specialistëve si për ecurinë dhe trajtimin e çështjeve të lidhura me procesin mësimor ashtu edhe me praktikën profesionale.	
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1	
- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;	Nga përvoja e vizitës në bibliotekën e Universitetit u pa se institucioni u siguron studentëve tekste mësimore cilësore dhe një literaturë të pasur në ndihmë të përgatitjes së studentëve.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Literatura në bibliotekën e Universitetit, duke patur parasysh se është një bibliotekë e re ishte e bollshme, por mendoj se më shumë duhet bërë në të ardhmen për pasurimin e saj me libra të rinj.
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Në bibliotekë gjetëm si botime periodike ashtu edhe librari elektronike, të cilat mendoj se në të ardhmen duhen pasuruar më tej, pasi shihej qartë që ishte një bibliotekë e re, me mjaft informacion por që kishte nevojë për pasurim të mëtejshëm.
Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një	Ky plan ishte hartuar dhe shpresoj që të realizohet

plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;	me ritmet e propozuara nga hartuesit e tij.
Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	Oraret ishin vendosur duke patur parasysh oraret e mësimi në mënyrë që studentët të kishin sa më shumë mundësi shfrytëzimi të mundësive që ofron biblioteka.
Konkluzione:	
Standardi V. 2 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;	Nga vizitat në mjediset e ndryshme të Universitetit Mesdhetari konstatoam se laboratorët, klasat e mësimi, studiot zotërojnë të gjitha pajisjet e nevojshme të kohëve të fundit për realizimin me nivel të programit të studimeve.
Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;	Nga konstatimet u vu re se pajisjet janë në gjendje të mirë pune dhe përmbajnë të instaluar të gjitha softëare-t e nevojshme për zhillimin normal të mësimi.
Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;	Nga konstatimet u vu re se pajisjet janë në gjendje të mirë pune dhe përmbajnë të instaluar të gjitha softëare-t e nevojshme për zhillimin normal të mësimi.
Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	Institucioni e zotëron këtë laborator për secilin program studimi.
Konkluzione: Mendoj se njëra nga pikat e forta të këtij universiteti është pikërisht vendosja në të gjitha mjediset e tij të pajisjeve të nevojshme elektronike si kompjutera, videoprojektorë, ekrane portativë etj. Të cilët janë jo vetëm përmbajnë programet e fundit në shërbim të leksioneve, por edhe mirëmbahen me kujdes nga personeli i universitetit.	
Standardi V. 3 - Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	Kjo duket qartë si nga bisedat me personelin ashtu edhe nga materiali i ofruar nga universiteti ku permenden Dhoma e Tregëtisë dhe e Industrisë së Tiranës me të gjitha bizneset dhe mundësitë e bashkëpunimit që ofrojnë për të zhvilluar praktikat e parashikuara për realizimin e programeve Master Profesional.
Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera	Po ashtu kontakte me aktorë të tjerë universiteti dëshmon se ka edhe me Aleancën e Biznesit të Kosovës, Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, dhe Shoqatën e Bankave të Shqipërisë.

publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	
Konkluzione: Institucioni dshmon se përmes kontakteve të shumta me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregëtisë, industrisë apo shërbimeve prodhuese apo edhe me aktorë të rëndësishëm nga sfera publike dhe private është në gjendje të ofrojë studentëve mundësi të mira për praktikat mësimore të të realizimit të programeve Master Profesional.	
VI - INSTITUCIONI KA DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;	Institucioni ka hartuar një raport ku pasqyrohen të gjitha kërkesat që përmenden në kriterin 1 të standardit VI.
Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	Institucioni ka dëshmuar deri tani se ka një situatë të shëndetshme financiare të aftë si për të siguruar mbarëvajtjen e institucionit ashtu edhe mbështetjen e programeve të zhvillimit në të ardhmen.
Konkluzione: Institucioni ka treguar qëndrueshmëri financiare të cilat mundësojnë si investime të tjera në infrastrukturë ashtu edhe vazhdimësinë e zhvillimit të programeve mësimore. E gjithë kjo situatë financiare pasqyrohet në raporte të hollësishme ku analizohen si kostot operacionale ashtu edhe ato të mjediseve, blerjes së pajisjeve. Ky element është i rëndësishëm pasi prej tij varet edhe ritmi i mëtejshëm i zhvillimit të UMSH-së dhe synimi për zgjerimin në të ardhmen të gamës së programeve që do të propozohen studentëve .	
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Përmes një rrjeti bashkëkohor të shkëmbimit të informacionit institucioni nxit në shërbim të funksionimit sa më të mirë të strukturave dhe njësisve të tij bashkëpunimin e pjestarëve të personelit si atij akademik ashtu edhe atij mesimor shkencor.
Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	Marrëdhëniet e efektshme të bashkëpunimit garantohej edhe nga një ndarje e qartë dhe racionale detyrash dhe përgjegjësish si dhe nga një procesi i vazhdueshëm analizash si të arritjeve ashtu edhe emangësive të vërejtura.
Konkluzione: Në universitetin Mesdhetari përdoren të gjitha potencialet që ofron rrjeti bashkëkohor i shkëmbimit të informacionit për të nxitur si bashkëpunimin e efektshëm midis personelit dhe duke siguruar kështu një funksionim optimal të strukturës. Po ashtu ky bashkëpunim garantohej edhe nga ndarja racionale e detyrave dhe përgjegjësive.	
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të	Në materialin e dorëzuar nga UMSH-ja renditet një

programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;	numër i madh universitetesh ku përfshihen Universiteti i Montpeliesë, i Paris-Est, i Marsejës, i Uestminsterit, për të përmendur vetëm disa prej tyre. Ndërsa sa për aktorët e biznesit vendas dhe të huaj janë po ata që përmendëm në standardin V.3.
Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;	Mbi këtë kriter nuk gjej asnjë informacion në materialin e dorëzuar si dhënë shënimet e mbajtura gjatë vizitës në UMSH.
Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;	Megjë akoma nuk ka kontigjente të punësuar të ketij universiteti (niveli i dytë) nuk janë organizuar trajnime të mëtejshme profesionale me punëdhënësit
Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nuk kam të dhëna mbi këtë kriter.
Konkluzione: <u>Përveç kriterit të parë i cili përmbushet plotësisht mbi tre të tjerët 2, 3,4 nuk kam asnjë të dhënë.</u>	
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË	
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;	UMSH i plotëson këto standarde, pasi aplikon programe të studimit të akredituara në nivelin e parë të studimeve dhe ndërkohë është në proces për të akredituar programet e studimit të nivelit të dytë.
Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;	Instrumentat e përdorura përmendura në materialin e dorëzuar nga UMSH janë instrumentat standard që përdoren të gjitha institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit.
Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;	Në mbështetje të Rregullores së UMSH nxitja dhe përmirësimi i performancës së mësimdhënies realizohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Curriculave e cila funksionon në përputhje me standartet e vendosura nga APAAL dhe ENQA. Rezultatet e kontrollit të saj i kalojnë Rektoratit dhe Bordit të Universitetit. Vlerësimet me shkrim të kontrolleve periodike të cilësisë për mësimdhënien shqyrtohen në një nga mbledhjet e Senatit dhe vendimet për përmirësimin e gjendjes merren në Senat.
Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;	Përmes mekanizmave formalë që disponon mendoj se universitetit nuk i mungon as vullneti dhe as mundësia që të shqyrtojë dhe miratojë kohë pas kohe programet e studimit.
Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;	UMSH-ja tregon qartë se synon t'i ndërgjegjësojë personelin akademik dhe atë mësimor shkencor si dhe studentët për rëndësinë e ruajtjes së standardeve të cilësisë së programeve.
Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	UMSH-ja ka si shqetësim të vazhdueshëm përmirësimin e nivelit të cilësisë së programeve, shqetësim të cilin e shfaq edhe në botimet e herëpashershme që ka nxjerrë.
Konkluzione:	

Është e dukshme nga programet dhe angazhimi i personelit se UMSH ka si shqetësim kryesor përmirësimin e cilësisë për të cilën ka hartuar politika dhe ndjek procedura të caktuara, si dhe përdor mekanizmat e nevojshëm për shqyrtimin dhe miratimin e programeve. Një element që nuk është lënë pas dore është ndërgjegjësimi i personelit dhe studentëve mbi

Analiza SWOT për implementimin e programit të studimit

Pikat e forta

1. Personel akademik I përgatitur
2. Si pjestar i Unionit të Universiteteve Mesdhetare, UMSH synon të zhvillohet në një mjedis ku objektivat për rezultate sa më të larta dhe zhvillim nuk mund të mbeten raste të vecanta, çfarë mundëson dhe garanton cilësi konkurruese në të gjitha programet e studimit.
3. Rekrutimi i personelit akademik, atij ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ mundëson një trajtim të mirë të tij për ta bërë sa më eficient në mësimdhënie
4. Prezenca e një infrastrukture të zhvilluar krijon hapsirat e kërkuara për realizimin e mësimdhënies pa u rrezikuar nga mungesa e standarteve në mjediset ku zhvillohet mësimi dhe mungesa e teknologjive të kohës

Pikat e dobëta

1. Mungesa e tregut privat për manaxherët e artit
2. Mungesa e një numri orësh formuese mbi teorinë dhe historinë e artit për menaxherët e artit.
3. Mungesa e leksioneve të shkruara në bibliotekën e UMSH përbën problem lidhur me aksesimin e tyre nga studentët
4. Në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve mungon paraqitja e lidhjeve me sistemin e nivelit të parë, çfarë bën që studentët të konsiderojnë se ajo çfarë kanë marrë në Bachelor nuk ka vlerë për studimin në nivelin e dytë

Rekomandimet

1. Vendosja e një numri orësh teorike formuese mbi artin për menaxherët e artit.
2. Të merren masat për organizimin konkret të praktikës mësimore
3. Të merren masa për përcaktimin e fushave ku mund të zhvillohen mikrotezat dhe të shpallen paraprakisht ato për tu njohur nga studentët
4. Të shihet mundësia e aplikimit të ndonjë kriteri për gjuhën angleze para fillimit të studimit në programin e nivelit të dytë

Grupi i Ekspertëve të Jashtëm

1. Dr. Gëzim Qëndro